REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
DREJTORIA E ARSIMIT - UPRAVA ZA OBRAZOVANJE
Primljeno: 17.06.2025
Organi / Organa | Numri-Broj | Shtojcë / Prilog | Vlera
05- | 184/01

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna e Vitisë- Opština Vitina- Municipality Vitina**

**DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT**

Në bazë të Ligit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale nenit 62, paragrafi 3 ( Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008; Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës, Ligjit nr. 08/L-153 për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, si dhe në bazë të nenit 4 paragrafi 8 të Udhëzimit Administrativ nr 03/2022 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë, Drejtoria Komunale e Arsimit në Viti më datë 17.06.2025 shpall:

**KONKURS**
**Për regjistrimin e fëmijëve në Çerdhen "Gëzimi Ynë" në Viti, në paralelet e ndara në fshatin Qifllak dhe fshatin Drobesh, për vitin edukativ 2025 – 2026**

**Grupmosha si në vijim:**

- **9 muaj - 2 vjeç**
- **2-3 vjeç**
- **3-4 vjeç**
- **4-5 vjeç**
- **5-6 vjeç**

Konkursi mbetet i hapur nga data: **17.06.2025 - 01.07.2025**

**Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e komunës së Vitisë.**

**Aplikacioni (Formulari i aplikimit) merret dhe dorëzohet ne Çerdhen "Gëzimi Ynë" në Viti, çdo ditë pune, duke filluar nga ora: 08:30 - 15:00.**

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Ekstrakti i lindjes së fëmijës ( origjinal, jo më i vjeter se 6 muaj):
- Letërnjoftimi i dy prindërve (kopje) ;
- Kontratat e dy prindërve që dëshmojnë se janë në marrëdhënie pune (kopje);
- Kartela e imunizimit të fëmijës-vakcionimit;
- Raport për gjendjen e përgjithshme shëndetësore të fëmiut.

**> Dokumentet e pa kompletuara nuk do të shqyrtohen.**

**Vërejtje:**

Institucioni - Çerdhja "Gëzimi Ynë" në Viti, duhet të veproj konform nenit 4, të Udhëzimit Administrativ me nr.03/2022 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë si dhe Ligjit nr. 08/L-153 për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme. Duke krijuar grupet përkatëse si dhe duke përcaktuar ecurinë e pergjithshme të regjstrimit, duke respektuar kapacitetet infrastrukturore dhe profesionale të institucionit.

Të gjithë aplikuesit që janë me lokacion më të afërt me institucionin parashkollor, pranohen në lokacionin më të afërt ( afërsia zonale - 4 km ).

Pas përfundimit të procedurave të konkursit, komisioni për pranimin e fëmijëve përpilon listën e të pranuarve eventual si dhe udhëzon prindërit për plotësim të dosjes së fëmijës së tyre me të dhënat shtesë të cilat dorëzohen në fillim të muajit shator. Atëherë kur bëhet regjistrimi i fëmijëve duhet të bashkangjiten edhe këto dokumente:

- Analizat mikrobiologjike ( strishoja e hundës, fytit dhe analiza për parazit në zorrë- (jo më të vjetra se 2 javë para se të registrohet fëmija)

Datë: 17.06.2025

Drejtoresha

Arta Ajeti

Scanned with CamScanner